



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **Studime evropiane**

Fakulteti	Shkencat Shoqërore Bashkëkohore
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	N-MESJD120C
Titulli	Magjistër i studimeve evropiane
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-41/2
Numri në arkiv i akreditimit []	03-41/4 (23.08.2019)
Vendimi për fillim me punë	03-41/4 (23.08.2019)
Data akreditimit	20.05.2019

Përshkrimi i programit

Programi studimor studime evropiane do t'i kualifikojë studentët për punë të pavarur dhe analitike profesionale në fushën e çështjeve evropiane në nivel kombëtar dhe në nivel të BE-së. Programi integron disa disiplina të studimeve evropiane: shkenca politike (në veçanti marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikat krahasimtare), ekonomi, drejtësi, shkenca shoqërore (me theks të veçantë në aftësitë metodologjike) dhe komunikim (duke theksuar rëndësinë e dy gjuhëve të huaja) me zbatimin e tyre në çështjet qendrore të integritimit evropian (BE) dhe të ndërtimit më të gjerë të Evropës.

Karriera

Programi studimor studime evropiane do të kualifikojë studentët për punësim në institucionet e BE-së dhe në organizatat tjera ndërkombëtare (evropiane), në nivel kombëtar, në veçanti në ministritë e punëve të jashtme, në ministritë për çështjet evropiane, ministrinë për zhvillim ekonomik dhe social; mundësi të punësimit janë gjithashtu edhe institucionet në nivel Gjithsejal (nga komunat dhe qytetet), OJQ-të, mediat dhe partitë politike, ekspertiza në fushën e proceseve të BE-së dhe politikat. Gjithashtu, tregu i brendshëm i punës bën të diplomuarit adekuat për sektorin e biznesit brenda dhe jashtë BE-së.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Tregon njohuri themelore dhe të kuptuarit për fushën shkencore të hulumtimit (ose studimit), duke identifikuar metodologji përkatëse për zgjidhjen e problemeve, si në mënyrë sistematike ashtu edhe në mënyrë kreative, gjë që ofron një bazë ose një mundësi për origjinalitet në zhvillimin dhe/ ose aplikimin e ideve autonome në kontekst të kërkimit;
- Tregon aftësi për identifikimin e njohurive të zgjeruara dhe të thelluara;
- Tregon nivel njohurish dhe kompetencë në një apo më shumë fusha të veçanta shkencore;
- Ka njohuri të një apo të më shumë lëmenj, të cilat, në fushat e caktuara shkencore, bazohen në hulumtime me më renome të hulumtimeve ndërkombëtare shkencore në këtë fushë shkencore.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Aftësi për zgjidhje kritike, të pavarur dhe krijuese të problemeve me një origjinalitet të caktuar në mjedise të reja ose dhe në kontekst multidisiplinar lidhur me fushën e studimit.

Aftësitë për të vlerësuar

- Aftësi sintetizimin dhe integrimin e njohurisë;
- Aftësi për t'u përballur me çështjet, sistematikisht dhe në mënyrë krijuese, për një vlerësim solid, madje edhe kur informacionet janë jo të plota ose të kufizuara, por të cilat i përfshijnë përgjegjësitë personale, sociale dhe etike në zbatimin e njohurive të fituara dhe të vlerësimit;
- Aftësi për identifikimin dhe përzgjedhjen e teorive shkencore, të metodologjive, mjeteve dhe shkathtësitë të përgjithshme nga fushëveprimi i lëndëve dhe inicimi i analizave dhe zgjidhjeve të reja në baza shkencore.

Aftësitë e komunikimit

- Aftësi për këmbimin e konkluzioneve dhe propozimeve me argumentim dhe me mbështetje racionale të tyre, si me persona profesionistë ashtu edhe me joprofesionistë, qartazi dhe paluhatsëm;
- Marrja e përgjegjësisë së konsiderueshme për rezultatet e përbashkëta; drejtimin dhe inicimin e aktiviteteve.

Aftësitë e të mësuarit

- Aftësi për njohjen e nevojave personale për dituri të mëtejshme edhe aftësi për veprim të pavarur dhe të mëvetësishëm gjatë fitimit të diturive dhe aftësive dhe shkathtësive të reja në korniza shoqërore;
- Aftësi për marrjen e përgjegjësisë për zhvillim dhe përkryerje profesionale të mëtejshme.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [MES-101] [9.0 SETK] **Politikat e BE**
- [MES-102] [6.0 SETK] **BE në Ekonominë Globale**
- [3.0 SETK] **Gjuhë e Huaj Profesionale 1**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (gjuhë e huaj)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [MES-201] [9.0 SETK] **Teoritë e Integritit Evropian**
- [MES-202] [6.0 SETK] **E drejta e Bashkimit Evropian**
- [3.0 SETK] **Gjuhë e Huaj Profesionale 2**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore (gjuhë e huaj)**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [MES-301] [9.0 SETK] **Seminar Hulumtues - Përgatitja e Tezës**
- [MES-302] [6.0 SETK] **Çështje Bashkëkohore në Bashkimin Evropian si Aktor Kryesor**
- [MES-303] [3.0 SETK] **Punë Praktike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 4

- [MES-400] [30.0 SETK] **Punimi i Magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Politikat e BE**

Lënda do të përqendrohet në temat që vijojnë: - Në analizën e politikave publike në zgjedhjen e problemeve shoqërore; në rrethanat historike që ndikojnë në gjenezën e analizës së politikave publike bashkëkohore, zhvillimi i analizës së politikave publike dhe tendat bashkëkohore në kërkimore në këtë fushë; specifika e zhvillimit të analizës së politikave publike në vende të ndryshme - SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Sllovenia ...) - Në procesin e politikave publike dhe ciklin e politikave publike (struktura / fazat e procesit të politikave publike dhe ciklin e politikave publike; ndërlidhja në mes të fazave të procesit të politikave publike; përcaktimin e agjendës dhe alternative për zgjedhjen e problemeve shoqërore). - Te aktorët relevantë në procesin e politikave publike (skena politike, rrjetet në politikë) dhe veçoritë e aktorëve shtetërorë (instrumentet e politikave publike); në llojet e analizës së politikave publike, qasjet e hulumtimit dhe modelet e analizës së politikës (pluralizmi i qasjeve dhe modeleve dhe aplikimi i të njëjtave); në rëndësinë e teorisë, qasjeve dhe koncepteve të analizës së politikave publike në hulumtimin dhe politikë-bërjen dhe zbatimin e politikave të përbashkëta evropiane në rrethanat e qeverisjes shumëshkallëshe; në zbatimin e analizës së politikave publike në tre politika; në kohezionin (politikat rishpërndarëse të BE), mjedisit (politikat rregulluese të BE) dhe arsimit (politika e zbatuar sipas metodës së hapur të koordinimit).

- **BE në Ekonominë Globale**

The course deals with the EU's position in the global economy and the EU's relations with key players of international economic relations (US, BRICS). The course analyzes the most important factors of a successful economy and main features of the EU, and more specifically examines the current policy dilemmas of the EU. The emphasis is on a comparison of the EU with important global economic spaces, identifying the comparative advantages and disadvantages of the EU and the possibility to improve its position in the world.

- **Teoritë e Integritit Evropian**

Në këtë lëndë do të analizohen teoritë kyçe të integritit evropian (federalizmi, funksionalizmi dhe neo-funksionalizmi, teoria liberale e bashkëpunimit ndërqeveritar), teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe teoria e shkencave politike nga konteksti i (jo) zbatueshmërinë së tyre në interpretimin dhe kuptimin e integritit evropian. Studentët do të fitojnë dije të thelluara në lidhje me një gamë të gjerë të qasjeve teorike për të kuptuar origjinën dhe zhvillimin e integritit evropian duke trajtuar mendimet e dijetarëve si David Mitrany, Ernst Haas, Karl Deutsch, Stanley Hoffman, Philippe Schmitter, Robert Keohane, Wayne Sandholtz, Andrew Moravcsik, Fritz Scharpf, Gary Marks dhe Thomas Risse. Lënda do tu ofroj studentëve që paralelisht të aplikojnë çdo teori në procesin e politikave publike (politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, politikat e drejtësisë dhe çështjet e brendshme, ekonomike dhe unioni monetar) si dhe në proceset e fundit në Bashkimin evropian, siç janë zgjerimin e Bashkimit evropian dhe ndërtimi e një identiteti evropian në sferën e mbrojtjes.

- **E drejta e Bashkimit Evropian**

Lënda synon në mënyrë kritike të vlerësoj zhvillimin e BE-së dhe të kornizës së saj institucionale dhe funksionimin e rendit juridik, si dhe raportet në me BE-së dhe shteteve anëtare. Struktura bazë e lëndës (që adaptohet në nivel vjetor në pajtim me zhvillimet e BE-së dhe rendit juridik) është si vijon: - Kuptimi i teorive dhe metodave të integritit evropian: një rivlerësim të zhvillimit të idesë së Evropës dhe në veçanti arsyet për suksesin e integritit evropian të pasluftës si dhe metodat kyçe të integritit; - Ndryshimet kushtetuese në Bashkimin Evropian: shtjellimi i BE-së si shtet dhe baza e "saj kushtetuese", krahasime të konstitucionalizmit evropian me rendin kushtetues të shteteve anëtare; - Ndërtimi i institucioneve të BE-së: analiza e ekuilibrit institucional, e sistemit të kontrollit e ekuilibrit ndërmjet institucioneve të BE-së dhe e roleve të tyre përkatëse në funksionimin e BE-së; - Ligji i BE-së, si rend juridik supranacional: kuptimi i parimeve themelore të ligjeve të BE-së (primati, efekti i drejtpërdrejtë, autonomia e ligjeve të BE-së) dhe sistemi i shqyrtimit gjyqësor sipas ligjeve të BE-së; - Zhvillimi i kufijve (kornizës) të ligjeve të BE-së: analizë të raporteve ndërmjet BE-së dhe shteteve anëtare (çështja e ndarjes së kompetencave legjislativë, parimi i subsidiaritetit), çështjet e hapura të supranacionalitetit evropian dhe solucionet për zgjedhjen e këtyre çështjeve; - Zhvillimi dhe kufijtë e komunitetit politik evropian: kuptimi i zhvillimit të BE-së në dritën e teorive bashkëkohore të federalizmit, çështja e finalitetit të integritit evropian, çështja e identitetit evropian dhe transformimet e mundshme kushtetuese në të ardhmen;

- **Seminar Hulumtues - Përgatitja e Tezës**

Në këtë lëndë studentët do të trajnohen në lidhje me metodat e ndryshme hulumtuese, do të dizajnojnë hulumtimin e tyre origjinal që mund të jetë bazë për tezën e magjistraturës. Në këtë lëndë do të përfshihen qasje dhe parime të ndryshme metodologjike (prej racionalizmit deri te relativizmi). Lënda po ashtu inkorporon qasje cilësore, sasiore dhe të përziera. Do të vlerësohen problemet reale. Me aplikimin e këtyre metodave kujdes i veçantë do t'i kushtohet: grumbullimit të të dhënave dhe vlerësimit të cilësisë së tyre edhe për burimet primare (anketa, intervista, fokus grupe) por edhe për të dhënat dytësore (vëmendje e veçantë u kushtohet të dhënave nga Eurostati), analiza e të dhënave,

prezantimi i rezultateve. Rekomandohet njohuri paraprake nga statistika dhe metodat hulumtuese (metodat multivariate apo ekonometri).

- **Çështje Bashkëkohore në Bashkimin Evropian si Aktor Kryesor**

Lënda përqendrohet në çështjet (analizë vertikale) politike, ekonomike, zhvillimin shoqëror, juridike, mbrojtjen e ambientit, energjinë në BE si aktor global. Premisa bazë e analizës është ndërrajonalizmi. Lënda ofron përkufizimin e koncepteve siç janë rajoni, rajonalizmi, rajonalizimi ndërrajonalizmi. Gjithashtu, përqendrohet në qasjet teorike të studimit të regionalizmit dhe ndër-rajonalizmit. Lënda ofron njohuri mbi aspektin historik të rajonalizmit si fenomen dhe si koncept për analizë teorike. Më pas në këtë lëndë ofrohet një mapim i aktorëve në rajonalizmin dhe rajonalizimin dhe ngrit analizën në nivel ndër-rajonal të raporteve të BE-së me: 1) rajonet e institucionalizuara (ndërrajonalizëm i 'pastër'): BE-ja në raport me rajonet dhe sub-rajonet amerikane (p.sh. OAS, Unasur, Mercosur, Komuniteti Andeve), rajonet dhe sub-rajonet afrikane (Unioni Afrikan, SADD, ECOWAS), rajonet dhe sub-rajonet aziatike (p.sh. ASEAN), sub-rajonet pacifike (Pacific Islands Forum), Gadishulli Arabik (Liga Arabe); 2) rajonet jo të institucionalizuara (ndërrajonalizmi 'hibrid'): BE - Unioni për Mesdheun, BE-ACP), dhe 3) çështjet brenda transrajonalizmit (p.sh. Takimi Azi-Evropë - ASEM).

- **Punë Praktike**

- **Punimi i Magjistraturës**

Ky modul u mundëson studentëve të transferojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre për kërkime dhe të bëjnë detyra më të ndërlikuara - punimin e magjistraturës. Moduli synon të jetë plotësisht praktik dhe studentët të fitojnë njohuritë e nevojshme dhe aftësitë e shkathtësitë që t'i qasen shkrimit të punimit. Moduli ka një rezultat kthyes - t'u mundësojë studentëve ta shkruajnë punimin e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me një efikasitet maksimal. Lënda ka për qëllim përmirësimin e teknikave të hulumtimit dhe stilit të shkrimit të punimit, duke mbajtur llogari për ndalesën e shërbimit me mjete të palejuara, si: plagjiatura dhe cenimi i të drejtave të autorit, që janë të ndaluara me Statutin e UEJL-së.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë Gjermane 1**

Lënda i njofton studentët me strukturat themelore të gjuhës gjermane. Pjesëmarrësit do t'i zhvillojnë aftësitë e tyre të komunikimit në lexim, në dëgjim, në të folur dhe në të shkruar. Kursi do i aftësojë ato për të realizuar biseda të thjeshta nga jeta e përditshme gjatë shitblerjes ose në restorant dhe të flasin drejtpërdrejt për të kaluarën. Ato do të njoftohen me strategjitë e kuptimit të të dëgjuarit dhe mund të përfitojnë informacione nga fusha e kulturës dhe civilizimit nga leximi i teksteve të thjeshta. Përveç asaj do të ushtrohen edhe veçoritë fonetike në kontekste komunikuese.

- **Gjuhë Gjermane 2**

Lënda është koncipuar për studentë me paranjohuri të gjuhës gjermane. Në këtë kurs do të tejkalohet komunikimi i thjeshtë, kështu që pjesëmarrësit, përmes strukturave komplekse të fjalisë, do të mund të raportojnë për familjen dhe miqtë e tyre, për planet e të ardhmes dhe të kaluarën. Ata do të mësojnë lakimin e mbiemrave. Ata do t'i ushtrojnë teknikat e të lexuarit dhe të dëgjuarit dhe përmes ushtrimeve të veçanta fonetike do ta përmirësojnë shqiptimin si dhe do të shkruajnë tekstet e para koherente.

- **Gjuhë Shqipe**

Përmes kësaj lënde do të sqarohen strukturat komplekse dhe kompetencat komunikative në gjuhën shqipe. Studentët do të jenë në gjendje të shprehin dëshirat dhe qëllimet e tyre dhe të pasqyrojnë sekuencat kohore. Ato do të mund të komunikojnë në situata të përditshme (si kërkimi i banesës, udhëtimi, orientimi, marrëdhëniet etj.). Objekt mësimi gjithashtu do të jenë edhe tekstet më të vështira të dëgjimit dhe leximit. Nga tekstet autentike (artikuj gazetash, tekste të shkurtra letrare etj.) studentët do të marrin informacione nga fusha e kulturës dhe civilizimit. Gjithashtu në fushën e të shkruarit do të ushtrohet edhe përpilimi i thjeshtë i llojeve të ndryshme të teksteve.

- **Gjuhë Angleze e Avancuar dhe Terminologji 1**

Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 1 është e dizajnuar për studentë të cilët kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze. Lënda ka për qëllim t'i avancojë edhe më tej katër shkathtësitë gjuhësore si: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Temat dhe terminologjia që do të përpunohen në këtë lëndë janë të lidhur me terminologjinë specifike të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij.

- **Gjuhë Angleze e Avancuar dhe Terminologji 2**

Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 2 është dizajnuar për studentët të cilët e kanë kryer me sukses lëndën gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 1. Ajo është përpiluar për t'i avancuar dhe më tej njohuritë e gjuhës angleze. Temat dhe terminologjia që do të përpunohen në këtë lëndë janë lidhur me agjencitë dhe trupat tjerë të Bashkimit Evropian.

- **Gjuhë Angleze e Avancuar dhe Terminologji 3**

Gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 3 është e dizajnuar për studentët të cilët e kanë kryer me sukses lëndën gjuhë angleze e avancuar dhe terminologji 2. Duke pasur parasysh se ky është niveli më i avancuar i gjuhës angleze, studentët do të bëjnë kërkime dhe do t'i diskutojnë temat dhe materialet e marra nga Biblioteka Qendrore e Bashkimit Evropian e cila lejon qasje në mënyrë elektronike dhe është e hapur për të gjithë ata që dëshirojnë t'i zgjerojnë njohuritë e tyre lidhur me evro-integrimet.

- **Gjuhë Gjermane 3**

Përmes kësaj lënde do të sqarohen strukturat komplekse dhe kompetencat komunikative në gjuhën gjermane. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje t'i shprehin dëshirat dhe qëllimet e tyre dhe të pasqyrojnë sekuencat kohore. Ata do të mund të komunikojnë në situata të përditshme (si kërkimi i banesës, udhëtimi, orientimi, marrëdhëniet etj.). Objekt mësimi, gjithashtu, do të jenë edhe tekstet më të vështira të dëgjimit dhe të leximit. Nga tekstet autentike (artikuj gazetash, tekste të shkurtra letrare etj.) studentët do të filtrojnë informacione nga fusha e kulturës dhe civilizimit. Gjithashtu në fushën e të shkruarit do të ushtrohet edhe përpilimi i thjeshtë i llojeve të ndryshme të teksteve.

- **Politika e Jashtme Evropiane**

Kjo lëndë përqendrohet në analizën e diversifikimit të politikave të përbashkëta të jashtme dhe të sigurisë së BE-së dhe në politikat e jashtme evropiane. Evoluimi i këtyre koncepteve pasqyrohet me analizën e kornizës primare të BE-së dhe zhvillimet më të reja të veprimeve të jashtme të BE-së. Gjithashtu në këtë lëndë përshkruhet kombinimi i politikave të përbashkëta dhe të sigurisë me relacionet e jashtme. Politika e jashtme evropiane ngërthen edhe politikat e jashtme të shteteve anëtarë të BE-së: Kështu, fillimisht lënda ofron një analizë gjithëpërfshirëse konceptuale të politikave të jashtme të shteteve dhe veprimit të jashtëm të BE-së. Së dyti, lënda ka për qëllim të aplikojë kornizën konceptuale në rastet individuale të veprimit të jashtëm të BE-së dhe politikat e jashtme të vendeve të zgjedhura. Kjo analizë realizohet në tri dimensione : a) analiza e ambientit të politikës së jashtme, b) analiza e procesit të politikës së jashtme (formulimi, vendimmarrje, zbatimi dhe c) analiza e politikës së jashtme (vlerat, qëllimet dhe strategjia).

- **Siguria Evropiane**

Lënda do të përqendrohet në analizën dhe vlerësimin e paradigmatave bashkëkohore të sigurisë, në procesin e evoluimit të konceptit të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes, bashkëpunimin në mes BE-së dhe NATO në sferën e sigurisë, si dhe rolin e institucioneve tjera evropiane në sferën e sigurisë (p.sh OSBE).

- **Analiza e Vlerave Evropiane**

Kjo lëndë përqendrohet në sintetizimin e qasjeve teorike dhe gjetjeve empirike në lidhje me dinamikën e ndryshimeve në shoqëritë evropiane në kontekstin zgjerimit të BE-së. Tema e hulumtimit është krahasimi, vlerësimi dhe interpretimi i observimeve, besimit, dhe sjelljes së popullatës së BE-së. Pyetësi që paraqet bazën empirike të lëndës paraqet koncept të gjerë tematik meqenëse ngërthen çështje siç janë vlerat politike, sociale, ekonomike dhe religjioze të popullatës në BE. Gjatë semestrit studentët do të përfitojnë njohuri me të gjitha dimensionet e hulumtimit krahasues në shkencat sociale duke shfrytëzuar data bazat „online“, me theks në zhvillimin e shkathtësive të interpretimit substancial, argumentimit në shkencat sociale, përdorimin analitik, sintezën dhe analizën e gjetjeve të hulumtimit.

- **Diplomacia e BE**

Lënda fokusohet në Bashkimin Evropian si një aktor në marrëdhëniet ndërkombëtare nëpërmjet aktivitetit diplomatik. Një segment i kësaj analize konceptualizon diplomacinë e BE-së në bazë të të qenit unik në BE si aktor shumë nivelësh dhe shumë anëtarësh, që hyn në marrëdhënie me aktorët tjerë (shtetet, organizatat universale dhe totale dhe aktorët joqeveritarë) në mënyrë unike. Korniza bazike juridike e diplomacisë së BE-së është shërbimi i veprimit të jashtëm evropian nocion i përcaktuar në Traktatin e Lisbonës dhe përbërja e saj është përcaktuar nga institucionet e BE-së dhe vendet anëtare të BE-së. Një vështrim i qasjeve teorike për hulumtimin e BE-së dhe politikës së jashtme nënkupton e aktiviteve bazike diplomatike të BE-së në botë. Lënda përqendrohet në aktorët e politikave të jashtme të BE-së dhe relacionet në mes tyre dhe bazën kontraktuale për veprimin e jashtëm të instrumenteve të politikave të jashtme të BE-së. Aplikimi i kësaj dije tek një numër i caktuar i rasteve në diplomacinë e BE-së siç janë: a) marrëdhëniet bilaterale (në mes të shteteve anëtare të BE-së dhe subjekteve të treta në marrëdhëniet

ndërkombëtare), b) marrëdhëniet multilaterale (në kuadër të Evropës dhe marrëdhëniet ndërkombëtare), dhe c) marrëdhëniet multilaterale (negociatat me BE-në dhe shtetet anëtare me vendet e treta në mënyrë individuale do të fokusohet në problemin e konsistencës së aktorëve të ndryshëm, objektivat dhe resurset e tyre në nivele të ndryshme të diplomacisë së BE-së.

- **Mirëqeverisja në BE**

Lënda trajton bazat teorike për analizën e mjedisit socio-ekonomik për zhvillimin dhe afrimin e shoqërisë së dijes dhe ekonomisë në kuadër të kornizës së BE-së. Kujdes i veçantë i kushtohet konceptit të qeverisjes (socio-ekonomike), siç është përkufizuar nga OECD në kuadër të tranzicionit nga ekonomia e hapur neoklasike dhe qasja konkurruese në një koncept ku elaborimi i objektivave strategjike, vlera dhe politikat për implementimin e tyre bazohen në konsensusin e palëve të interesuara në nivel të BE-së, shteteve anëtare dhe rajoneve. Analiza përfshin marrëdhëniet interaktive si dhe sinergjinë pozitive / negative në kuadër të kornizës zhvillimore globale, përmbajtjen dhe kulturën e vendimeve dhe politikave në BE, planifikimin dhe zhvillimin e politikave të përbashkëta siç janë: arsimit i lartë, politikat e zhvillimit ndërkombëtar, politikat në sferën e inovacionit, si dhe në determinantat tjera të zhvillimit që rezultojnë me zhvillim ekonomik, cilësi të jetesës dhe ambientit, si dhe në identitetin e përbashkët të BE-së dhe shteteve anëtare. Kujdes të veçantë i kushtohet procesit të formulimit të politikave në kuadër të BE-së dhe qeverisjes gjatë fazave të implementimit si në nivelin e BE-së ashtu edhe të shteteve anëtare.

- **BE dhe Zhvillimi Global**

Kjo lëndë trajton çështjen e zhvillimit të vendeve të botës së tretë dhe relacionet e tyre me vendet e zhvilluara, kryesisht me BE. Kujdes i veçantë në këtë lëndë u kushtohet problemeve të brendshme të zhvillimit duke analizuar tiparet specifike të ambientit socio-ekonomik të këtyre vendeve si dhe mënyrën e intervenimit të BE-së si donator më i madh në nivel global. Duke marrë parasysh se aspektet ndërkombëtare ndikojnë në zhvillimin ekonomik, çështjet si tregtia ndërkombëtare, ndihmat dhe investimet kanë trajtim të veçantë në këtë lëndë. Lënda ka përmbajtjen si vijon: - Përkufizimi dhe përmbajtja e ekonomisë zhvillimore, trajtimi historik i zhvillimit ekonomik, teoritë dhe strategjitë e zhvillimit, çështjet dhe problemet e zhvillimit (dimensioni i jashtëm dhe dimensionin e brendshëm); - Varfëria/distribucioni i drejtë i pasurisë; - Çështjet e popullsisë -, demografia, shëndetësia, arsimit; - Punësimi, zhvillimi rural dhe urban, migracioni; - Bujqësia në vendet në zhvillim. - Problemet e zhvillimit dhe çështjet/ aspekte ndërkombëtare / të jashtme: - Tregtia ndërkombëtare; - Financat ndërkombëtare dhe zhvillimi: ndihmat për zhvillim, çështjet e borxhit; - Investimet e drejtpërdrejta të jashtme dhe zhvillimi; - Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi.